

Biografia

Kostaq Beluri është anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, i zgjedhur nga Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve, si përfaqësues i Prokurorisë së Përgjithshme. Ai është diplomuar për Drejtësi pranë Universitetit të Tiranës (*pa shkëputje nga puna*) dhe ka përfunduar studimet edhe në Fakultetin Ekonomik, Dega Financë.

Përvoja e tij e punës fillon me emërimin fillimisht si hetues në Hetuesinë e Rrethit Korçë, për të vazhduar në Hetuesinë e Rrethit Tiranë e më pas si Oficer i Policisë Gjyqësore në Prokurorinë e Rrethit Tiranë.

Është emëruar si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Tiranë me Vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ka ushtruar funksionet e zv/Prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Tiranë nga viti 1999 deri në vitin 2004.

Nga viti 2004 deri në vitin 2007 ka qënë Drejtor i Drejtorisë Kundër Krimin të Organizuar dhe Mbrojtjes së Dëshmitarëve në Ministrinë e Brendëshme. Nga viti 2007 deri në vitin 2013 ka ushtruar funksionet e zv/Drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

Për gjatë një viti, 2013 -2014 ka ushtruar funksionet (i komanduar) si Drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë. Nga viti 2014 e në vazhdim ka qënë prokuror në Prokurorinë e Përgjithëshme. Prej datës 19 dhjetor 2018, ushtron funksionin e anëtarit në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

Z. Beluri është ekspert pranë Shkollës së Magjistraturës. Mandati i tij në detyrën e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë është një mandat me afat tre vjeçar, i vlefshëm nga dhjetori 2018 deri në dhjetor 2021.